

## Besa/ Plas sherri te skuadra e Kavajes

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 05 Dhjetor 2013 22:46

---



Grushta, shkelma dhe shume ofendime. Tek skuadra e Beses ka plasur sherri ne fund te stervitjes ditën e enjte. Bernard Berisha eshte zene me Shaqir Stafen pas nje perplasje ne fushe. Te dy lojtaret nuk i kane mbajtur nervat dhe menjehere jane ofenduar se bashku per te nisur me pas sherrin. Te dy jane goditur disa here dhe menjehere ka nderhyre trajneri por dhe shoket e skuadres per ti ndare. Pas rezultateve pozitive ka ardhur edhe ky sherr i panevojshem si per te treguar se ne Kavaje jane dehur nga suktesi i javeve te fundit.